

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-022/14

**Prishtinë,
4 dhjetor 2014**

Në çështjen juridike të:

V. H.

Podujevë

Pala përgjegjëse në kërkesë/pala ankuese

kundër

P. J.

Serbi

Paraqitësi i kërkesës/pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Willem Brouwer, Kryetar i Kolegjit, Esmë Erterzi dhe Sylejman Nuredini, gjyqtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/196/2013 i datës 18 prill 2013 (lënda e regjistruar në AKP me numër KPA13946), pas shqyrtimit të mbajtur më 4 dhjetor 2014, mori këtë:

AKTGJYKIM

Ankesa e V. H. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/196/2013 i datës 18 prill 2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA13946), hidhet poshtë si e paaftshme.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 8 nëntor 2006 pala përgjegjëse në ankesë, atëherë paraqitësi i kërkesës P.J. ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) ku ka kërkuar vërtetimin e së drejtës pronësore dhe ri-posedimin e një ngastre toke në Livadicë, Podujevë, “Fusha e Livadicës”, ngastra kadastrale nr. 200/2, në sipërfaqe prej 06.00.00 ha (në tekstin e mëtejme të referohet si: prona).
2. Ai ka pretenduar se pronë e ka trashëguar pas vdekjes së babait të tij, me 1/3 e pjesës ideale bazuar në vendimin për trashëgiminë në vitin 1994. Ai ka thënë se shteti e kishte konfiskuar pronën gjatë viteve të 40-ve por i ishte kthyer familjes së tij në vitin 1991 përmes procedurave gjyqësore. Ai më tej ka thënë se është larguar nga Kosova për në Beograd para 20 viteve, kështu pra para konfliktit, por gjatë 90-ve ia kishte dhënë me qira pronën disa komshinjve. Më tej ka thënë se e kishte humbur posedimin ndaj pronës për shkak të konfliktit të armatosur që ka ndodhur ndërmjet viteve 1998/1999.
3. Pala përgjegjëse në ankesë ka paraqitur para Komisionit një kopje të fletës poseduese me nr. 152 të lëshuar më 17 gusht 1994 nga Autoritetet e Gjeodezisë së Republikës së Serbisë – Zyra kadastrale për pasuri të paluajtshme, një kopje të fletës poseduese nr.152 të lëshuar më 17 maj 1995 nga Autoritetet e Gjeodezisë së Republikës së Serbisë – Zyra kadastrale për pasuri të paluajtshme, ku emri i palës përgjegjëse në ankesë shfaqet si bashkëpronar i pronës, dhe se vendimi për trashëgiminë nr. II-0-1380/94 i lëshuar më 31 gusht 1994 nga Gjykata e katërt komunale e Beogradit, ku emri i palës përgjegjëse në ankesë shfaqet si njëri nga trashëgimtarët/bashkëpronarët e pronës.
4. Nuk është kontestues fakti se familja e palës përgjegjëse në ankesë e ka shfrytëzuar këtë tokë deri në vitet e 40-ta.
5. Nuk kundërshtohet fakti se pas viteve të 40-ve dhe para konfliktit të armatosur në vitet 1998/1999 prona është shfrytëzuar nga persona tjerë.
6. Është e pavend për rastin në fjalë fakti se në çfarë baze këta individët tjerë e kanë shfrytëzuar pronën në fjalë pas 1940-ve dhe deri në konfliktin e armatosur.

7. Njoftimi i pronës është bërë në vitin 2007, 2010 dhe 2013 dhe prona është gjetur të jetë kultivuar nga person i panjohur.
8. Pala ankuese, pastaj pala përgjegjëse V. H. ka nënshkruar njoftimin për pjesëmarrje në procedurë më 19 janar 2007. Ai nuk e ka kërkuar të drejtën pronësore ndaj pronës. Në vitin 2008 në formë të përgjigjes në kërkesë ai ka deklaruar se prona nuk i takon palës përgjegjëse në ankesë por Ndërmarrjes Shoqërore Kooperativës Bujqësore “Perparimi” nga Podujeva. Ai ka shtuar se prona i është marr nga familja e tij në vitin 1918 “[...kur kolonët erdhën nga Serbia dhe familja Jovic erdh nga Krushevi ...]”. Ai më tutje ka thënë se nuk mund të ofrojë dokumente për pronën pasi që për shkak të luftës të gjitha dokumentet janë shkatërruar. Ai ka paraqitur disa dokumente ku ka provuar ta dëshmojë se ka marr pjesë në procesin e privatizimit të organizuar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) për ta shitur pronën në vitin 2006.
9. KKPK-ja e ka refuzuar kërkesën. KKPK-ja ka pranuar që “[...prona e kërkuar është e regjistruar si pronë shoqërore në fletën poseduese të azhurnuar. Pasi vetëm prona private mund të trashëgohet, vendimi për trashëgiminë i paraqitur nga paraqitësi i kërkesës është qartë i pavlejsbëm, prandaj, nuk mund të merret parasysh në rastin aktual]”. Për më tepër, vendimi i KKPK-së tregon se pala përgjegjëse në ankesë ka dështuar të paraqes prova se ai kishte bërë përpjekje për të intervenuar në procesin e privatizimit. KKPK-ja konkludon se pala përgjegjëse në ankesë ka dështuar ta provojë të drejtën pronësore apo ndonjë të drejtë tjetër prone ndaj pronave të kërkuara menjëherë para apo gjatë konfliktit të viteve 1998-99.
10. Vendimi nuk i është dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë pasi që ai ka refuzuar ta pranojë. Më 17 tetor 2013, vendimi i është dorëzuar palës ankuese. Ai ka paraqitur ankesë më 20 nëntor 2013. Korrespondenca e AKP-së tregon se ankesa e paraqitur nuk është pranuar nga pala përgjegjëse në ankesë.
11. Pala përgjegjëse në ankesë nuk ka paraqitur përgjigjen në ankesë.

Pretendimet e palës ankuese:

12. Pala ankuese pohon se vendimi është i paligjshëm dhe i padrejtë sepse nuk ia ka njohur të drejtën e parablerjes, dhe mundësimi për palën përgjegjëse në ankesë ta pengojë bartjen e së njëjtës pronë. Ai ka shtuar se prona ishte e tija dhe se e njëjta është uzurpuar nga pala përgjegjëse në ankesë dhe persona tjerë në vitin 1936. Kjo është mundësuar nga Qeveria e Serbisë, e cila i ka sjellë ata si kolon. Ai më tutje ka thënë se pala përgjegjëse në ankesë duke qenë në dijeni për këto kushte, 20 vite më parë e ka lejuar palën ankuese ta punojë këtë pronë dhe se ai madje i ka ofruar atij mundësinë për ta blerë pronën në rast se do të

vendosnin ta shisnin të njëjtën. Ai propozon që kolegji ta pranojë ankesën e tij si të bazuar duke ia njohur atij të drejtën e parablerjes, dhe ta parandalojë bartjen e pronës së kërkuar nga pala përgjegjëse në ankesë.

Arsyetim ligjor:

Pranueshmëria e ankesës:

13. Ankesa është e papranueshme sepse është paraqitur jashtë kornizës ligjore në përputhje me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (në tekstin e mëtejme Ligji nr. 03/L-079) për zgjidhjen e kërkesave pronësore lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, që parasheh se: *“brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi ankesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës”.*
14. KKKP-ja ka vendosur për këtë lëndë me vendimin e vet KPCC/D/A/196/2013 të datës 18 prill 2013. Ky vendim i është dorëzuar palës ankuese më 17 tetor 2013. Afati për paraqitjen e ankesës ishte 18 nëntor 2013, dhe ankesa është paraqitur nga pala ankuese më 20 nëntor 2013. Rrjedhimisht, në pajtim me nenin 13.3 (b) të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenit 195.1 (a) të LPK-së, ankesa është dashur të hidhet poshtë si e paafatshme.
15. Gjykata nuk gjeti asnjë arsye se pse pala ankuese duhet të arsyetohet për këtë vonesë. Ai ishte njoftuar mjaftueshëm rreth afatit (vendimi përmbante një paralajmërim në gjuhën shqipe) dhe vet pala ankuese nuk dha asnjë arsyetim rreth vonesës.
16. Në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenin 13.3 (b) të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenit 195.1 (a), gjykata vendosi si në dispozitiv.

Këshillë juridike:

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Willem Brouwer, Gjyqtar i EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Esma Erterzi, Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it